



Republika e Kosovës



Komuna e Kaçanikut

- Këshilli Komunal Për Siguri në Bashkësi (KKSBB)-

01.Nr. zyrtar/ 2023

**Procesverbal**

Takimi i IV-të i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2023

Më 30.08.2023

Në takim prezantuan:

**Besim Ilazi**, Kryetar i Komunës

**Jaser Jaha**, Stacioni i Policisë-Kaçanik

**Fatmir Qaka**, EVSB

**Shemsedin Abazi**-KLSP

**Elmihane Malsiu**-HANDIKOS

**Bujar Bajra**-Sektori i Emergjencave Civile Komunale

**Ylber Tusha**-Përfajqsuesi i Bizneseve

**Fidaim Fazliu**-KBI

**Naim Hysa**-Kryqi i Kuq Komunal

**Jashar Selimi**-Këshilli i Prindërve

**Menduh Krasniqi**-Inspektorati Komunal

**Fadil Guri-Zyra** për Kthim dhe Komunitete

**Ekrem Livoreka**-Komiteti për Komunitete

**Përfajqsuesi i FSK**

**Vedat Dema**-Zyra për Barazi Gjinore

Mbledhjen e kryesoi Kryetari i Komunës me këto pika të rendit të ditës :

- 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
- 2.Gjendja e sigurisë në territorin e Komunës së Kaçanikut
- 3.Trajtimi i ambientit dhe menagjimi i mbeturinave gjatë stinës së verës
- 4.Të ndryshme

1.Procesverbali u miratua nga të pranishmit

### **2.Gjendja e sigurisë në territorin e Komunës së Kaçanikut**

Për gjendjen e sigurisë në periudhën në mes dy takimeve Kryetari i dha fjalën zv. Komandatit të Policisë z. Jaser Jaha

**Jaser Jaha** – Gjendja e sigurisë në periudhën në mes dy takimeve ka qenë e qetë dhe stabile .

Gjatë kësaj periudhe kohore kemi pasur gjithsej 93 raste të raportuara .

Janë konfiskuar 5 armë dhe 77 vepra penale .

I gjithë stafit policor ka qenë i angazhuar në realizimin e planit dhe nënplaneve operative për sezonin e verës pasi që kjo sezonë ka pas shumë frekuentim të njerëzve dhe automjeteve .

Edhe pse ka qenë një periudhë e ngarkuar per shkak të prezencës së mërgimtarëve mundë të themi se situata është menagjuar mirë.

Ka pasur aksidente trafiku me dëmtime materiale .

Angazhimi ynë është edhe në planin e sigurisë nëpër shkolla ku kemi përgatitur aktivitete që do të i implementojmë .

Kohëve të fundit janë punësuar zyrtarë të rinjë policor të cilët po ndihmojnë në zbatimin e planeve operative që i kemi në kuadër të stacionit policorë .

Drejtoria rajonale ka angazhuar roje të pyjeve në parkun nacional gjë që na e ka lehtësuar punën në këtë pjesë ku ne vetëm asistojmë kur të kërkohet prezenca jonë .

Asistime kemi pasur edhe nëpër njësi dhe institucione tjera ku vlenë të përmendet një rast pengim të ushtrimit të detyrës zyrtare me qrast janë arrestuar 6 persona dhe dy janë në arrati .

Me këtë raشتë duke u marrë prokuroria për procedurë të mëtutjeshme .

### **3.Trajtimi i ambientit dhe menagjimi i mbeturinave gjatë stinës së verës**

Në pikën e tretë të rendit të ditës Kryetari fjalën ja dha zyrtarit Komunal për ambient.

**Afrim Fuga** – Sektori i ambientit ne Komunë në bashkpunim me GIZ dhe Agjensionin për Menaxhim të Mbeturinave gjatë punës në teren kemi identifikuar 19 Deponi ilegale , 7 prej tyre janë eliminuar dhe këto hapsira janë zëvendësuar me gjelbrim.

Shumica e këtyre deponive është nga materiali i objekteve të rrënuara dhe për këtë sugjeroj që të gjindet një hapsirë për këto deponi .

Në Kuvendin Komunal është aprovuar plani për menagjim të mbeturinave 2023-2027.

Jemi në hap të mirë për përpilimin e një plani ndërkomunal në nivel regional që do të mundeson një menagjim më të mirë të mbeturinave.

**Hasip Salihu** – Zyrtarë i Kompanisë „Pastërtia” - Ne si kompani jemi munduar që të jemi në shërbim të qytetarëve në çdo kohë .

Në këtë periudhë kohore ka qenë një fluks më i madh i qytetarëve e sidomos nga diaspora por që falë mjeteve dhe stafit të kësaj kompanie ia kemi dalë që të kryejmë shërbimet në çdo pjesë të Komunës .

**Menduh Krasniqi** – Inspektorati Komunal në vazhdimësi ka kryer inspektimet e përbashkëta duke përfshirë akterët e mjedisit si Policinë e Kosovës , Inspektoratin e njësisë së Mjedisit dhe të Minjerave .

Si Inspektorat kemi dhënë 3 gjoba falë raporteve dhe dëshmive që kemi marrë nga Policia e Kosovës

Në bashkpunim me Inspektoratin e Minjerave kompanive ilegale të gurthyeseve u janë konfiskuar makineri .

Sa i përket dëmtimit të pyjeve në Parkun Nacional ne si Inspektorat kemi bërë njoftime e raporte për nivelin qëndror por prapë gjendja është e pa përmirësueshme .

Kemi marrë masa edhe ndaj operatorëve që ju nënshtronen lejeve mjedisore .

Krahas njoftimeve , urdhëresave dhe rekomandimeve , inspektorati komunal ka dhanë edhe gjoba mandatore .

Nga Inspektori i Mbrojtjes së Mjedisit deri më tanë kemi 7 gjoba e që shuma është 1650 euro e në bashkpunim me Inspektoratin e Minjerave kemi dhënë 3 gjoba në vlerë 15,000 euro , me qrast u është konfiskuar edhe makineria .

Ndaj prerësve ilegal të pyjeve kemi shqiptuar gjobë në shumë prej 4150 euro.

**Elmihane Krasniqi** – Në një takim që kemi pasur me grupin e auditimit social në njësitin e zjarrëfikësve të cilët së shpejti do të vendosen në fshatin Trimor afér objektit të kompanisë

„Pastërtia”, ata kan ngritë një shqetësim për kudërmim të erërave të automjeteve të kësaj kompanie

**Hasip Salihu** – Ne disponojm 4 kamion të rinjë për mbledhjen e mbeturinave të cilët janë në gjendje të mirë dhe për çdo mëngjes pastrohen .

Mundë të ndodh që nëse ofrohesh shum afër të ndiesh kundërmimin përndryshe kjo makineri është në gjendje të rregullt dhe mirëmbahet .

**Remzi Reka** – Krahasuar me të kaluarën gjendja në trajtimin e mbeturinave ka ndryshuar për të mirë .

Sipas disa informacioneve që kam shërbimet në mbledhjen e mbeturinave ka arritë në 70 % por që edhe kjo pjesë e mbetur duhet që të realizohet .

Shqetësim është deponitë e mbetjeve inerte që duhet të angazhohemi në trajtimin e këtyre mbetjeve .

Shqetësimet janë edhe me ujërat e zeza , deponitë e mbeturinave nëpër përroska e lumenjë që në rast të ndonjë vërvshimi mundë të vërshojnë nëpër rrugë .

Uroj që mos të kemi sanksione në investime sa i përket impianteve që janë planifikuar të ndërtohen në Kosovë .

Apeloj te Inspektorati Komunal dhe Policia e Kosovës që të kryejn detyrat e tyre dhe të mos ketë tolerancë për askënd që dëmton mjedisin .

#### 4.Të ndryshme

**Jashar Selimi** – Kisha një pyetje për Drejtoren e Arsimit lidhur me atë se sa janë përgatitur shkollat për fillimin e vitit të ri shkollorë .

**Fadil Guri** – Përgëzoj Policinë e Kosovës për një aksion bastisjesh e kontrollë që ka bërë ktonitë dhe mendoj se kësia aktivitetet duhet të ndërrmiren më shpesh .

**Jaser Jaha** – Aksioni i fundit i Policisë ka qenë i organizuar në bashkëpunim me nivelin qendëror ndërsa aktivitetet tona të kontrollimit nëpër lokale e kafiteri ku gravitojnë të rinjë do të vahdojnë edhe në të ardhmen . Ne asistojmë edhe në rastet kur ftohemi nga Inspektorati Komunal në loakalet që nuk e respektojnë orarin e punës .

**Remzi Reka** – Shqetësuese për mua si qytetarë është ekspozimi i mallrave nga marketet në temperaturat e larta , poashtu një brengë dhe shqetësim i madh është telat e tensionit të lartë të rrjmës elektrike afër pullazeve të shtëpive .

Të ndërrmiret diçka sa nuk është bërë vonë , përndryshe këto dy dukuri ka kohë që janë prezente.

**Ekrem Livoreka** – Mos funksionimi i kamerave të sigurisë është një brengë e madhe për qytetarët .Më intereson ta dijë se kush është përgjegjës për mirëmbajtjen e këtyre kamerave .

**Kryetari** – Do i kisha përbledhur në pikë të shkurta të gjitha diskutimet që u përmendën nga ju lidhur me shqetësimet që i preukupojnë qytetarët .

U ngritë si shqetësim mbeturinat inerte e që është përgjegjësi pikërisht e imja si Kryetarë , por që për momentin ende nuk kemi gjetur një hapsirë të duhur për këto mbeturina .Si çështje tjetër u përmendën ujërat e zeza nëpër Lumenjë .

Ne si Komunë kemi ndarë një parcelë prej 6 hektarë për Impiant dhe uroj që iniciativa për ndërtimin e Impiantit do të bëhet realitet .

Gjitashtu kemi bërë kërkesë me projekt në Ministrinë e Ambientit për dy kolektorë që sadopak të zbusë kët gjendje të ndotjes së Lumin Nerodime por që ende nuk kemi marrë ndonjë përgjigje positive. Kërkesat tona me projekte konkrete do të vazhdojnë edhe në të ardhmën.

Uji i pijshëm një brengë e madhe qytetare por që edhe në këtë pjesë ne si Komunë nuk kemi çasje ngase menagjohet nga niveli qendrorë .Ne jemi munduar që së paku me forcat vetanake të e rregullojmë infrastrukturën .

Menagjimi jo i mirë ka bërë që të kemi mungesë të ujit të pijshëm por që është edhe hezitimi i nivelit qendrorë për të komunikuar e bashkëpunuar me nivelin lokal .

Kemi mungesë të Inspektorit Sanitarë i cili poashtu ka kaluar në nivelin qendrorë e ne këtu ballafaqohemi me problematika dhe shqetësime rreth ekspozimit të mallrave ushqimore nëpër rrugë e gjëra tjera që nuk kemi kompetenca të i rregullojmë .

Informatën që e kamë marrë nga Drejtori i Arsimit , të gjitha shkollat janë të gatshme të fillojnë procesin mësimor pos shkollës fillore Emin Duraku në Dushkajë e cila do të fillojë më vonë për shkak të disa punimeve që janë duke u bërë .

Lidhur me mos funksionimin e kamerave të sigurisë nëpër qytet mundë të ju them se investimin në blerjen e 50 kamerave e kemi bërë si Komunë por që mirëmbajtja i ka takuar Policisë .

Është një problematikë që do zgjidhje por që duhet të dihet se kush do ti mirëmbajë këto kamera.

**Fadil Guri** – Ujërat e zeza në Lumin Nerodime është një shqetësim i madh për gjithë komunitetin që jetojnë përreth këtij lumi .

Sugjeroj që si prioritet në investime Komunale të ju ipet këtij komuniteti që lumi të futet në shtrat dhe besoj se do të bëhet një zgjidhje .

**Kryetari** – Prioritet e kemi që të gjithë përrenjtë dhe dy lumenjtë të futen në shtrat por që bugjeti është i pa mjaftueshëm që për një kohë të shkurtë të investohet në këtë drejtim .

Lumi Nerodime zgjidhjen e ka nëse ndërtohet Impianti , përndryshe edhe nëse vendoset në shtrat prap gjendja nuk ka me ndryshu sa i përket kundërmimit të erës .

**Remzi Reka** – Deshta me u ndërlidh me një problematikë që ka ndodhur në rrugën më frekuentuese në qytet e që fjala është përrugën „Qamil Ilazi” .

Mirë që është bërë rruga një kahshe por që sipas mendimit tim kemi gabuar që kemi bërë edhe vend parkingje në këtë rrugë ngase është vështirschuar lëvizja e lirë e qytetarëve .

**Kryetari** – Ankesa kemi pasur vetëm nga bizneset ndërsa nga qytetarët këmbësorë nuk kemi pasur ankesa .

Gabimi është bërë ndoshta për kohën e testimit të kësaj rruge njëkahëshe ngase është bërë në kohën kur ka pasur më së shumti frekuentim të automjeteve .

Kët çështje mund ta diskutojm në të ardhmen dhe mundemi edhe ta ndryshojm projektin por që duhet ta dimë që ne si Komunë nuk kemi hapsira të mjaftueshme për parkingje .

**Naim Hysa** – Rruga Dushkajë- Stagovë është vështiruar për automjete ngase drunjët me dega kanë dalë në rrugë dhe po krijojnë pengesa .

**Kryetari** – Kët rrugë e mirëmbajmë ne si Komunë dhe mirë që e ngrite si problematikë për të reaguar tek përgjegjësit e mirëmbajtjes së rrugëve .

#### REKOMANDIMET

- 1.Të sigurohen hapësira për deponitë inerte .
- 2.Të pastrohen makinerit e kompanisë Pastërtia me qëllim të evitimit të kundermimit të erërave .
- 3.Toleranc 0 për ata që ndotin dhe shkatërrojnë Mjedisin .
- 4.Kontrolle më të shpeshta të Policisë nëpër lokale në të cilat frekuentojnë të rinjët me qëllim të parandalimit të dukurive negative .
- 5.Të punohet më shumë në eliminimin e ujërave të zeza nëpër rrugë e lumenjë .
- 6.Të kërkohet një zgjidhje për funksionimin e kamerave të sigurisë .
- 7.Angazhim edhe më i madh në mirëmbajtjen e rrugëve .

Kryesoi

Kryetari - Besim



Procesmbajtës

Fatmir Çaka